



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2023

## **KËRKESË**

**KËRKUES:** **35 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë** (jo më pak se  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Kuvendit).

**OBJEKTI:** Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike.

**BAZA LIGJORE:** Neni 77 i Kushtetutës së Shqipërisë;  
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;  
Ligji nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”.

**DREJTUAR:** **Znj. Lindita NIKOLLA**  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Funksionarët publikë kanë detyrimin ligjor dhe moral që në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre të shmangin cdo situatë, në të cilën interesat e tyre private mund të prevalojnë mbi interesat publikë. Kjo realizohet nëpërmjet vendimmarrjeve të paanshme, transparente dhe në interesin më të mirë të mundshëm të publikut, duke ruajtur dhe konsoliduar besimin e tij te institucionet publike. Funksionari publik duhet të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti, që publiku të mos krijojë qoftë edhe hijc dyshimi, se një vendimmarrje caktuar është udhëhequr pjesërisht apo plotësisht nga interesat private të zyrtarit.

Pikërisht, me qëllim realizimin e këtij qëllimi thelbësor në një shtet demokratik dhe të së drejtës, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar. Këto dy akte imponojnë detyrime të qarta për funksionarin publik për të shmangur cdo lloj situate konflikti interesë, duke deklaruar përpara fillimit të detyrës, gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë të përvitshme, dhe pas përfundimit të detyrës interesat e tij privatë. Kontrolli i deklaratave kryhet nga një institucion i specializuar si ILDKPKI.

Megjithë bazën ligjore dhe strukturat institucionale, vitet e fundit janë vërejtur disa raste kur jo vetëm nuk ka një ndarje të qartë mes interesave privatë dhe publikë të zyrtarit shtetëror, por ka hije të forta dyshimi se funksionarët e lartë shtetërorë janë udhëhequr nga interesat e tyre private apo familjare në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive të tyre. Në vijim, do të sjellim disa shembuj që vetëm ilustrojnë sa më lart. Konkretisht, biznesmeni Pandi Carapuli, një mik i afërt i kryeministrat Edi Rama, ndërtuesi i vilës së tij personale në fshatin Surrel, pronar i kompanisë “Eurocol” ka fituar kontrata publike nga institucione qëndrore dhe vendore me vlerë miliona euro, si dhe statusin e privilegjuar të investitorit strategjik me firmë të vetë kryeministrat.

Një tjetër rast flagrant i ndërthurjes së interesave private me ato të interesave publike, është ai i bashkëshortit të ish-ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe deputetes të PS-së, Znj. Olta Xhaka. Kompania që zotërohet nga bashkëshorti i Znj. Xhaka, edhe ky i fundit ish-deputet i PS-së, Z. Artan Gace nëpërmjet kompanisë së tij “AG.TCC” sh.p.k., përfitoi statusin e investitorit strategjik për ndërtimin e një hoteli disa katësh me sipërfaqe zhvillimi mbi 10 mijë m<sup>2</sup>. Ndërsa masat e ndryshme lehtësuese të akorduara nga Komiteti i Investimeve Strategjike, që drejtohet nga kryeministri dhe bëjnë pjesë disa kolegë ministra të Znj. Xhaka, është edhe e drejta e përdorimit të bregut të detit për ndërtimin e disa stacioneve plazhi për një periudhë 30-vjecare.

Po aq flagrante imbetet rasti kur në fund të vitit 2021, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste propozoi amendimin e Kushtetutës, me qëllim që anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit t’iu zgjatej mandati për rreth 2 vite deri më 31 Dhjetor 2024. Një prej nënshkruesve të projektligjit kushtetues ishte edhe ministrja për Infrastrukturën dhe Energjinë, njëkohësisht deputetja e PS-së, Belinda Balluku. Kjo e fundit injoroi faktin se kryetare e KPK-së ishte Pamela Qirko, e motra e saj, duke shënuar kështu një rast të paprecedentë në historinë e parlamentarizmit ku një ministre dhe deputete propozon nisma që prekin drejtpërdrejtë familjarë të rrëthit të saj më të ngushtë.

Këto raste, por edhe të tjera janë ugritur publikisht nga deputetë të Partisë Demokratike, përfshirë edhe adresimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë dhe ILDKPKI, por fatkeqësisht nuk kanë marrë përgjigje, duke zbehur kështu besimin e publikut se veprimitaria e institucioneve publike dhe vendimmarjet e funksionarëve të lartë janë të cliruara nga cdo lloj ndikimi i interesave private dhe udhëhiqen vetëm nga interesit publik. Në këto kushte, vlerësojmë të nevojshme ngritjen e një komisioni hetimor, i cili do të shqyrtojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri rastet e deritanishme, dhe vlerësojë masat e nevojshme, përfshirë ndërhyrjet ligjore, me qëllim garantimin e integritetit në vendimmarje të funksionarëve publikë në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të tyre.

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i

*pakicës parlamentare*”, që realizohet “...në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila duke i pasur të kufizuara mjetet në dispozicion, mund ta shndërrojë atë në një instrumet të fuqishëm kushtetues.

Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik dhe shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik. Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërbën pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për cështje të vecanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara.

Qëllimi i Komisionit Hetimor që kërcohët të krijohet mbi bazën e kësaj kërkese, synon që të mbledhë informacione të hollësishme mbi zbatimin e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe deklarimin e interesave privatë, si dhe të vlerësojë nevojën për miratim, korrigjim, ndryshim të legjislacionit relevant, përkatesisht të ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore kushtetuese, për shkak se nuk sjell mbivendosje apo transferime të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon njohjen dhe verifikimin në hollësi të të gjitha rasteve problematike që lidhen me konfliktin e interesave, me qëllim që të kontrollohet zbatimi i legjislacionit në fuqi, të nxirren përgjegjësitë institucionale, si dhe të merrin masa të përshtatshme në drejtim të parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

E drejta e Komisionit për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyra kushtetuese që mbulojnë deputetët, si përfaqësues të popullit dhe zëdhënës të interesit publik, për zbardhjen e plotë të kësaj cështjeje. Dobishmëria e këtij hetimi konsiston pikërisht në nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve dhe mirëfunkcionimin e shtetit të së drejtës.

Nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare, natyra e cështjeve të hetuara nga komisionet hetimore ka qenë e një rëndësie substanciale apo parësore për publikun, me ndikim të vecantë në marrëdhëni ndërshtetërore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive institucionale dhe mospërsëritjen e fenomeneve të hetuara në të ardhmen. Në këtë drejtim, cështjet më të shumta kanë patur për objekt administrimin e fondeve publike, marrëdhëni ndërshtetërore, falimentimet e korporatave

apo subjekteve të ndryshme private, të cilët kanë patur një impakt në ekonominë e vendit, apo hetimin e fenomeve kriminale.<sup>1</sup>

Në rastin konkret, puna e Komisionit Hetimor nuk do të konsistojë në nxjerjen e përgjegjësive penale për personat që potencialisht mund të kenë kryer shkelje, pasi kjo është detyrë funksionale e organeve të drejtësisë. Komisioni Hetimor do të përqendrojë punën e tij në në njojhen dhe verifikimin në thellësi të ligjshmërisë të praktikave institucionale për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Nga ana tjetër, mbledhja e informacioneve të detajuara nga institucionet relevante synon që në përputhje me realitetin e diktuar nga rrethanat, provat dhe të dhënat në dispozicion, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korrigimit të ligjeve të vecanta, me qëllimin që të garantojë vendimmarje të paanshme, të pavarura, transparente dhe në interesin më të mirë të publikut, duke konsoliduar besimin e qytetarëve tek institucionet shtetërore.

Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor, përbush tri kriteret kushtetues si vijon: (i) cështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhë funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; (ii) objekti i hetimit fokusohet në një cështje konkrete; dhe (iii) ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e problematikës lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksioneve publike nga funksionarë të lartë.

Kërkesa për ngritjen e një Komisioni Hetimor për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, bazohet në nenin 77, pika 2 e Kushtetutës, i cili parashikon se: “*Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkësë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një cështje të vecantë.*”, si dhe neni 25 i Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se “*1. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkësën e një së katërtës së të gjithë anëtarëvë të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi, për të shqyrtuar një cështje të vecantë. 2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.*”

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, nc, një grup deputetësh, jo më pak se  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës dhe nenin 25, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit,

### **KËRKOJMË:**

1. Ngritjen e një Komisioni Hetimor të Kuvendit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike.
2. Komisioni ka për objekt të veprimtarisë së tij: (i) shqyrtimin e të gjitha problematikave të deritanishme dhe kontrollin e veprimtarisë së institacioneve të ngarkuara për trajtimin e rasteve të

<sup>1</sup> Vendimi Nr. 18/2003 i Gjykatës Kushtetutese;

konfliktit të interesave; dhe (ii) vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore nëpërmjet miratimit, korrigjimit apo plotësimit të legjislativit relevant për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.



3. Komisioni do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe katër anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe gjashë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

4. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

5. Mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për shqyrtimin e kësaj kërkese dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend në seancën plenare më të afërt.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

#### DEPUTETËT

- 1- Gërmant Boroshi 
- 2- Apron Gjermesky 
- 3- FSIK Sotku 
- 4- Flaminj Basha 
5. Edmond Spas 
6. Bujar Lekaj 
7. RDI PALORI 
8. Farzem Vahabzaf 
9. Raftirot Dibrëli 
10. Jutg' Zelili 
11. Jelonec Hoxha 
12. Sali Bumila 
13. Albion Veshi 
14. Dard Bylykbashi 
15. Asllan Akgani 